**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR**
**TIRANE** 34260

34260

**VENDIM**
**PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK**

Sot, më datën 31.10.05, unë gjyqtarja pranë Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tirane, Znj. [signature] pasi u njoha me kërkesën e paraqitur nga shoqëria "GARANTSIG IPP" Sh.a., me Drejtor Ekzekutiv Z. Kico Loli për regjistrimin si person juridik te kësaj shoqërie, ne regjistrin tregtar ne baze te ligjit 7667, date 28.01.1993,

**KONSTATOVA**

**Aksionaret:**

1. "Iliria B" sh.p.k., person juridik i regjistruar me vendimin nr. 32482 date 01.12.2004 te kësaj Gjykate,
2. "KURUM INTERNATIONAL"sh.p.k. person juridik i regjistruar me Vendimin nr. 20268 date 10.11.1998 te kësaj Gjykate,
3. "SIGMA" sh.a., person juridik i regjistruar me Vendimin nr. 20487 date 21.12.1998 te kësaj Gjykate,

kane vendosur te themelojnë një shoqëri anonime, te emërtuar "GARANTSIG IPP"SH.A.

**Objekti i veprimtarisë se shoqërisë është:**

1. Mbledhja e kontributeve dhe dhënia e përfitimeve, personave te përfshirë ne Institutin Privat te Pensioneve, ne përputhje me rregulloren e pensioneve dhe kushtet e kontratave individuale te lidhura me ta.
2. Investimi i pasurisë se Institutit Privat te Pensioneve ne vende te sigurta sipas përcaktimeve te bëra ne ligjin nr. 7943, date 01.06.1995 "Për pensionet suplementare dhe institutet private te pensioneve"(i ndryshuar).

**Kapitali i shoqërisë**

Sipas kërkesës se ligjit për shoqëritë aksionare është ne shumen 2.000.000 (dy milion) leke, i pjesëtuar ne 2.000 (dy mije) aksione duke pasur çdo aksion vlerën nominale prej 1.000 leke secila.

Kapitali aksionar mbulohet si me poshtë:

1."ILIRIA B" sh.p.k., 51% te kapitalit aksionar te shoqërisë,
2. "KURUM INTERNATIONAL" sh.p.k., 25% te kapitalit aksionar te shoqërisë,
3. "SIGMA" Sh.a, 24% te kapitali aksionar te shoqërisë.

**Selia e shoqërisë** do te jete ne "Tirana Internacional Hotel", Sheshi Skënderbej, Tirane.

**Kohëzgjatja** e shoqërisë do te jete për një periudhe 20 vjeçare.

**Organet e shoqërisë** janë :

1. **Asambleja e Përgjithshme**;
2. **Këshilli Mbikëqyrës** i përbëre nga:

| | |
|---|---|
| Z. Luan Bregasi | Kryetar |
| Z. Zeki Kaya | Zv/Kryetar i pare |
| Znj. Vasilika Joxhi | Zv/Kryetar i dyte |
| Z. Qemal Disha | Anëtar |
| Z. Pandeli Llukmani | Anëtar |
| Z. Galina Gjoni | Anëtar |
| Z. Tajar Bregasi | Anëtar |

3. **Bordi Drejtues** i përbëre :

| | |
|---|---|
| Z. Kico Loli | Drejtor Ekzekutiv |
| Znj. Teuta Bregasi | Anetar |
| Z. Vladimir Kareco | Anetar |
| Znj. Burbuqe Bendo | Anetar |
| Znj. Elona Lagji | Anetar |

4. **Eksperti Kontabël i autorizuar** është caktuar z. Paqësor Qato.

Duke qene se dokumentet e paraqitura plotësojnë kushtet sipas ligjit nr. 7943, date 01.06.1995 "Për pensionet suplementare dhe Institutet Private te Pensioneve" (i ndryshuar), ligjit "Për Shoqëritë Tregtare" dhe ligjit "Për Regjistrin Tregtar", kërkojmë qe te regjistrohet si person juridik shoqëria tregtare "GARANTSIG IPP" sh.a.

Kërkesat dhe dokumentacioni janë te drejta, te plota dhe duhen pranuar:

**PER KETO ARSYE**

Ne baze te ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 dhe ligjit nr. 7667 date 28.01.1993

**VENDOSA**

Te pranoj kërkesën për regjistrimin si person juridik te shoqërisë tregtare "GARANTSIG IPP" Sh.A. ne regjistrin tregtar me aksionare:

1. "ILIRIA B" sh.p.k., 2. "KURUM INTERNATIONAL" sh.p.k., 3. "SIGMA" sh.a.

**Kapitali i Shoqërisë**

Sipas kërkesës se ligjit për shoqëritë aksionare është ne shumen 2.000.000 (dy milion), i pjesëtuar ne 2.000 (dymijë) aksione duke pasur çdo aksion vlerën nominale prej 1.000 (njëmijë) leke secila.

**Kapitali aksionar** mbulohet si me poshtë:

1. "ILIRIA B" sh.p.k, 51% te kapitalit aksionar te shoqërisë,
2. "KURUM INTERNATINAL" sh.p.k., 25% te kapitalit aksionar te shoqërisë,
3. "SIGMA" sh.a., 24% te kapitalit aksionar te shoqërisë.

**Selia e shoqerise** do te jete ne "Tirana Internacional hotel", Sheshi Skënderbej, Tirane.

**Kohëzgjatja** e shoqerise do te jete për një periudhe 20 vjeçare.

**Organet e shoqerise** janë :

**Asambleja e përgjithshme;**

**Këshilli mbikëqyrës** i përbëre nga :

| | |
|---|---|
| Z. Luan BREGASI | Kryetar |
| Z. Zeki KAYA | Zëvendëskryetar i pare |
| Znj. Vasilika JOXHI | Zëvendëskryetar i dyte |
| Z. Qemal DISHA | Anëtar |
| Z. Pandeli LLUKMANI | Anëtar |
| Znj. Galina GJONI | Anëtar |
| Z. Tajar BREGASI | Anëtar |

**Bordi Drejtues** i përberë:

| | |
|---|---|
| Z. Kico Loli | Drejtor Ekzekutiv |
| Znj. Teuta Bregasi | Anetar |
| Z. Vladimir Kareco | Anetar |
| Znj. Burbuqe Bendo | Anetar |
| Znj. Elona Lagji | Anetar |

**Eksperti Kontabël** i autorizuar është caktuar z. Paqësor Qato.

Kundër këtij vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit, Tirane.

U shpall sot me date 31.10. 2005.

GJYQTARE
Altina XHOXHAJ

# AKT-THEMELIMI

# I

# SHOQERISE

# "GARANTSIG IPP"

## Neni 1

Ne baze te ligjit Nr. 7943, date 1.06.1995 "Per pensionet suplementare dhe institutet private te pensioneve suplementare", themeluesit si dhe ligjit "Per shoqerite tregtare":

**1. "ILIRIA B" ; 2. "SIGMA SH.A"; 3."KURUM INTERNATIONAL" SHPK;**

deklarojne se, kane nenshkruar kete kontrate dhe kane themeluar kete shoqeri, ne baze te ketij Akt Themelimi, duke respektuar edhe kerkesat e legjislacionit shqiptar ne fuqi.

## Neni 2

## REGJIMI JURIDIK,EMERTIMI

Forma ligjore e organizimit te kesaj shoqerie eshte **Shoqeri aksionere**. Emri i saj do te jete **"GARANTSIG IPP"**.

## Neni 3

## OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Objekti i veprimtarise se shoqerise "GARANTSIG IPP" do te jete:
1. Krijimi i nje fondi privat pensionesh, si nje shoqeri me kapital te perbashket nga te gjithe aksioneret.
2.Mbledhja e kontributeve suplementare dhe dhenia e perfitimeve suplementare, personave te perfshire ne fondin privat te pensioneve, ne perputhje me rregulloren e pensioneve dhe kushtet e kontratave individuale te lidhura me ta.

3.Investimi i pasurise se fondit privat te pensioneve ne vende te sigurta sipas percaktimeve te bera ne ligjin nr.7943, date 1.06.1995 "Per pensionet suplementare dhe institutet privatete pensioneve" (i ndryshuar).

Per arritjen e ketij qellim Shoqeria ka te drejte te bashkepunoje me persona juridike apo fizike brenda apo jashte vendit te cilet kane te njejtin qellim.

**Neni 4**

**SELIA E SHOQERISE**

Shoqeria "GARANTSIG IPP",do te kete seline e saj ne Tirane, ne adresen "Hotel "Tirana International".

**Neni 5**

**USHTRIMI I VEPRIMTARISE**

Shoqeria "GARANTSIG IPP", do te ushtroje veprimtarine ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj. Ajo mund te hape dege te saj ne te gjithe Shqiperine dhe jashte saj, ne perputhje me rregullat e percaktuara per kete qellim ne Statutin e saj.

**Neni 6**

**KOHEZGJATJA**

1.Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise "GARANTSIG IPP" do te jete 20 vjet (njezet vjet) duke filluar nga data e rregjistrimit te saj ne Gjykaten e Shkalles se Pare Tirane.

Me vendim te Asamblese se Pergjithshme, Shoqeria mund te prishet edhe para se te mbaroje periudha 20 vjeçare (njezet), ose te shtyhet kohezgjatja e saj me tej se 20 vjetet (njezet). Rregullat dhe proçedurat qe do te ndiqen per kete do te jene ato te percaktuara ne legjislacionit shqiptar ne fuqi.

## Neni 7

## TE ARDHURAT

Te ardhurat per financimin e veprimtarise se shoqerise per realizimin e qellimit dhe objektit te veprimtarise do te sigurohen nga:
-Kontributet e personave te siguruar ne te
-kontributi i punedhenesve per te punesuarit e tyre;
-te ardhura nga investimi sipas vendimit te marre nga Asambleja e Pergjithshme;
-Fonde te siguruara nga shoqeria nepermjet donacioneve te ndryshme,
-Te ardhurat nga veprimtaria ekonomike e shoqates,
- Ne çdo forme tjeter te ligjshme qe lejohet nga legjislacioni shqiptar.

## Neni 8

## ADMINISTRIMI I TE ARDHURAVE

Shoqeria "GARANTSIG IPP" ushtron veprimtari fitimprurese. Te ardhurat qe rezultojne nga veprimtaria e shoqerise do te administrohen nga Bordi Drejtues dhe Keshilli Mbikqyres, ne perputhje me percaktimet e dhena nga Asambleja, dhe Statuti saj per realizimin e qellimit dhe objektit per te cilin ajo eshte krijuar.

Shoqeria "GARANTSIG IPP" nuk eshte pergjegjese per detyrimet e anetareve te bordit drejtues dhe te kryetarit te tij, te cilat ata i ka te rrjedhura nga veprimet qe jane jashte detyrave apo atributeve te dhena nga vete ajo.

## Neni 9

## PERFAQESIMI

Shoqeria perfaqesohet ne lidhje me te tretet nga Drejtori Ekzekutiv i Bordit Drejtues, i cili eshte personi qe do te ndjeke edhe procedurat per rregjistrimin e saj prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Drejtor Ekzekutiv emerohet z. Kiço Loli.

## Neni 10

## DISPOZITA TE FUNDIT

Pjese e pandare e Aktit te Themelimit eshte Statuti, i cili do te nenshkruhet njeherazi nga themeluesit.

## THEMELUESIT

**"ILIRIA B" Sh.p.k**

**Perfaqesuarnga**

**Luan BREGASI**

**"KURUM INTERNATIONAL" Sh.p.k**

**Perfaqesuar nga**

**Zeki KAYA**

**"SIGMA" SH.A.**

**Perfaqesuar nga**

**Qemal DISHA**

# STATUTI

## I Shoqerise Anonime te emertuar "GARANTSIG IPP" sic u kodifikua nga Asambleja e Pergjithshme

### KAPITULLI I

### KRIJIMI-EMERTIMI- SELIA-QELLIMI-KOHEZGJATJA

**Neni 1**
**Krijimi-Emertimi**

Krijohet Shoqeria Anonime me emertimin "GARANTSIG IPP".
Ne rast se Shoqeria kontrakton me persona te huaj, emertimi i saj mund te perdoret ne perkthim te sakte ne gjuhet e huaja respektive.

**Neni 2**
**Selia, Filialet, Agjensite**

1. Selia e Shoqerise caktohet qyteti Tirane, ku edhe zgjidhet cdo kontradikte, pervec rastit kur Ligji e percakton ndryshe.
2. Me vendim te Keshillit Mbikqyres mund te krijohen filiale dhe agjenci ose thjesht perfaqesi te Shoqerise neper qytete te ndryshme te Shqiperise ose jashte saj. Ne aktin themelues te filialeve qe do te krijohen percaktohet objekti i tyre, si dhe detyrat, kompetencat dhe pergjithesisht shtrirja e juridiksionit dhe e funksionimit te tyre.

**Neni 3**
**Qellimi**

Qellimi i Shoqerise eshte:
1. Krijimi i nje Instituti privat pensionesh, si nje shoqeri me kapital te perbashket nga te gjithe aksioneret.
2.Mbledhja e kontributeve suplementare dhe dhenia e perfitimeve suplementare, personave te perfshire ne Institutin privat te pensioneve, ne perputhje me rregulloren e pensioneve dhe kushtet e kontratave individuale te lidhura me ta.
3.Investimin e pasurise se Institutit privat te pensioneve ne vende te sigurta sipas percaktimeve te bera ne ligjin nr.7943, date 1.06.1995 "Per pensionet suplementare dhe et privatete pensioneve" (i ndryshuar).

Per arritjen e ketij qellim Shoqeria ka te drejte te bashkepunoje me persona juridike apo fizike brenda dhe jashte vendit te cilet kane te njejtin qellim.

## Neni 4
## Kohezgjatja

1. Kohezgjatja e Shoqerise percaktohet ne baze te ketij Statuti ne 20 vjet (njezet vjet) duke filluar nga data e rregjistrimit te saj ne Gjykate.
3. Me vendim te Asamblese se Pergjithshme, Shoqeria mund te prishet edhe para se te mbaroje periudha 20 vjeçare (njezet), ose te shtyhet kohezgjatja e saj me tej se 20 vjetet (njezet), ne baze te legjislacionit shqiptar.

# KAPITULLI II

# KAPITALI THEMELTAR, NDRYSHIMI I KAPITALIT THEMELTAR

## Neni 5
## Kapitali themeltar

1. Kapitali themeltar i Shoqerise, percaktohet ne shumen 2.000.000 mije (dy milione) leke, i pjesetuar ne 2000 (dymije) aksione duke patur çdo aksion vleren nominale prej nje mije (1.000) leke secila. Kapitali themeltar do te depozitohet ne Banken Raiffeisen me qender ne Tirane.
Aksionet jane te pandashme.

## Neni 6
## Zmadhimi i kapitalit themeltar

2. Kapitali themeltar zmadhohet vetem me vendim te Asamblese se Pergjithshme, e thirrur ne menyre te jashtezakonshme, ndryshimit te Statutit, mbi bazen e raportit te Keshillit Mbikqyres.
Kapitali themeltar zmadhohet nepermjet emetimit te aksioneve te reja ose nepermjet rritjes se vleres nominale te aksioneve.
Aksionet e reja shlyhen me para ne dore ose me kontribut ne natyre. Ne rast se zmadhimi i kapitalit behet me kontribut ne natyre, me vendim te Gjykates perkatese, emerohen nje ose me shume eksperte te cilet do te percaktojne vleren e ketij kontributi ne baze te nenit 162 dhe kufizimet e neneve 168, 169 te Ligjit 7638/92.
Aksioneret kane te drejte perparesie ne nenshkrimin per rritjen e kapitalit. (E drejta e perparesise).
Zmadhimi i kapitalit themeltar duhet te realizohet brenda dy vjeteve nga dita qe Asambleja e Pergjithshme ka miratuar kete zmadhim (neni 153, Ligji 7638/92).

## Neni 7
## Zvogelimi i kapitalit themeltar

Zvogelimi i kapitalit themeltar autorizohet ose vendoset nga Asambleja e Pergjithshme e thirrur ne menyre te jashtezakonshme. Ne Asamblene e Pergjithshme te thirrur per zvogelimin e kapitalit dorezohet raporti i arsyetuar i Keshillit Mbikqyres, duke shpjeguar arsyet qe bejne te detyrueshem marrjen e vendimit perkates. Ne te gjitha rastet zvogelimi prek aksioneret ne te njejten mase ne perpjestim me vleren e aksioneve qe zoterojne, ne baze te nenit 164, te Ligjit 7638/92.

Projekti i zvogelimit te kapitalit u komunikohet eksperteve kontrollore te autorizuar, te pakten 45 (dyzete e pese) dite perpara mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme qe thirret per te vendosur mbi kete projekt.

**Neni 8**
**Shlyerja dhe verifikimi i kapitalit**

Nuk mund te merret vendim dhe te realizohet zmadhimi i kapitalit aksioner me para ne dore, nese kapitali aksionar i deritanishem nuk eshte shlyer plotesisht. Ne rast te kundert operacioni i zmadhimit te kapitalit dhe leshimit te aksioneve te reja konsiderohet i pavlefshem, ne baze te nenit 153, te Ligjit 7638/92. Keshilli Mbikqyres ne çdo rast te zmadhimit te kapitalit duhet qe ne nje afat 3 (tre) mujornga realizimi i zmadhimit te kapitalit te verifikoje depozitimin e kapitalit. Nese kapitali nuk eshte mbuluar plotesisht, ateher Keshilli Mbikqyres disponon lirshem aksionet e pambuluara tek te tretet, ose kapitali aksioner shtohet deri ne shumen e mbulimit te tij.

**Neni 9**
**Garancia Bankare e depozituar nga themeluesit**

Themeluesit e shoqerise "GARANTSIG IPP" SH.A, kapitalizojne nje shume ne formen e garancise prej 10 milione leke (dhjete milione), ne Banken "Raiffeisen" me qender ne Tirane.
Shuma e kapitalizuar ne formen e garancise do te bllokohet per 3 vjet duke filluar nga data e rregjistrimit te shoqerise "GARANTSIG IPP" SH.A dhe me pas do te kthehet ne fond rezerve.
Kur shoqeria "GARANTSIG IPP" SH.A, likujdohet per rastet e parashikuara ne ligj, shuma e kapitalizuar ne formen e garancise do te sherbeje per te mbuluar borxhet e mundshme te saj.

**KAPITULLI III**
**AKSIONET**

**Neni 10**

1. Aksionet e Shoqerise jane anonime, nominative, dhe nenshkruhen nga Kryetari i Keshillit Mbikqyres dhe nga nje anetar i ngarkuar prej ketij Keshilli.
Per aksionet do te leshohen tituj transferimi ne baze te ligjit, tipi i te cilave do te vendoset nga Keshilli Mbikqyres. Aksioni nominativ u transferohet te treteve, ne baze te nenit 198, te Ligjit 7638/92.
Titujt e aksioneve mund te perfshijne nje ose me shume aksione. Ne kohen e themelimit te Shoqerise ose gjate ekzistences se saj mund te krijohen aksione me perparesi qe kane avantazhe ne raport me te gjitha aksionet e tjera sipas nenit 148 & 149 te Ligjit 7638/92.
Çeshtjet e tjera lidhur me emetimin e aksioneve rregullohen nga Keshilli Mbikqyres.

**Neni 11**

Aksionet jane te pandashme kundrejt Shoqerise, e cila njeh vetem nje pronar kryesor te nje aksioni. Çdo aksion jep te drejten e nje vote. Ne rastin kur per nje aksion ka me

shume se nje zoterues, atehere te drejtat e tyre duhet t'i ushtrojne nepermjet perfaqesuesit te tyre, por nese kane nuk kane caktuar perfaqesues, aksioni nuk perfaqesohet dhe ushtrimi i te drejtave qe vijne si pasoje e tij pezullohen.

Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga çdo aksion i ushtron vetem pruresi i tij i ligjshem.

Aksioneret ushtrojne te drejtat e tyre persa i perket Bordit Drejtues te Shoqerise, nepermjet Asamblese se Pergjithshme te Aksionereve.

**Neni 12**

Ne rastin kur kushdo aksioner deshiron te transferoje nje pjese ose te gjitha aksionet e tij, eshte i detyruar qe me perpara te beje te njohur me shkrim tek Keshilli Mbikqyres, duke bere te njohur edhe vleren e aksioneve, me qellim qe aksioneret te ushtrojne te drejten e parablerjes per blerjen e ketyre aksioneve.

Keshilli Mbikqyres eshte i detyruar brenda dhjete diteve nga marrja e lajmerimit perkates te lajmeroje me shkrim te gjithe aksioneret e tjere. Aksioneret e tjere kane per detyre qe brenda afatit njezet (20) ditor te bejne te njohur tek Keshilli Mbikqyres nese do te ushtrojne te drejten e parablerjes apo jo.

Ne rast se numri i aksionereve qe interesohen per blerje aksionesh eshte me i madh se nje, do te marrin aksion ne perpjestim me numrin e aksioneve qe zoterojne. Çdo transferim aksionesh qe behet ne kundershtim me kete nen eshte i pvlefshem dhe nuk sjell rezultat te ligjshem si per aksionet ashtu edhe per Shoqerine.

**Neni 13**
**Te drejtat e pakices**

1. Ne rast kerkese te aksionereve qe perfaqesojne te pakten nje te dhjeten (1/10) e Kapitalit Aksionar te vene, Keshilli Mbikqyres eshte i detyruar te therrase Asamblene e Pergjithshme te jashtezakonshme te aksionereve, duke caktuar diten e mbledhjes se saj, e cila nuk duhet te jete me vone se tridhjet (30) dite nga dita e dorezimit te kerkeses Kryetarit te Keshillit Mbikqyres. Ne kete kerkese duhet te percaktohet saktesisht objekti i rendit te dites.

2. Ne rast kerkese te aksionereve qe perfaqesojne te pakten nje te dhjeten (1/10) te Kapitalit Aksionar te derdhur, Presidenti i Asamblese se Pergjithshme eshte i detyruar ta shtyje nje here marrjen e vendimeve te Asamblese se Pergjithshme te zakonshme ose te jashtzakonshme, duke cakuar si dite te mbledhjes per marrjen e ketyre vendimeve ate dite qe percaktohet ne kerkesen e aksionereve, por kjo dite nuk duhet te jete me vone se tridhjete (30) dite nga dita e shtyrjes.

3. Ne rast kerkese te aksionereve qe perfaqesojne te pakten nje te dhjeten (1/10) e Kapitalit Aksionar te derdhur, e cila duhet t'i dorezohet Shoqerise pese dite te plota para Asamblese se Pergjitheshme te zakonshme, Keshilli Mbikqyres eshte i detyruar:

a. Te komunikoje ne Asamblene e Pergjithshme shumen e dhene gjate dy vjecarit te

fundit per cdo shkak nga ana e Shoqerise anetareve te Bordit Drejtues ose nepunesve te tjere te tij, si dhe cdo dhenie tjeter te Shoqerise ketyre personave, ose çdo Kontrate tjeter te Shoqerise, te hartuar per cdo shkak, me keta persona.
b. Te jape informacione konkrete qe i kerkohen lidhur me ceshtjet e shoqerise, ne masen qe ato jane te dobishme per vleresimin real te ceshtjeve te rendit te dites. Keshilli Mbikqyres mund te refuzoje te jape informacionet qe i kerkohen, per arsye bindese duke shenuar motivacionin perkates ne protokoll.

4. Ne rast kerkese te aksionereve qe perfaqesojne te pakten nje te treten(1/3) te Kapitalit Aksionar te derdhur, e cila i dorezohet Shoqerise brenda afatit te pershkruar ne paragrafin e meparshem dhe kur keta aksionere nuk perfaqesohen ne Keshillin Mbikqyres, ky Keshill eshte i detyruar t'u jape atyre gjate Asamblese se Pergjithshme ose, nese deshiron, para saj, perfaqesuesve te tyre, informacione mbi ecurine e ceshtjeve te Shoqerise dhe per gjendjen e pasurise se Shoqerise. Keshilli Mbikqyres mund te refuzoje te jape informacionet qe i kerkohen, per arsye thelbesore bindese duke shenuar motivacionin perkates ne protokoll.

5. Ne rastet e germes "b" te parag. 3, dhe te parag. 4 te ketij neni, cdo diskutim lidhur me shenimin e motivacionit, zgjidhet nga Gjykata kompetente e shkalles se pare te selise se Shoqerise, me anen e procedures se masave siguruese.

## KAPITULLI IV
## ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

### Neni 14

Organet drejtuese te Shoqerise"GARANTSIG IPP" jane:

a. Asambleja e Pergjithshme
b. Keshilli Mbikqyres
c. Bordi DrejTues.

## ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

### Neni 15
### Perberja e Asamblese se Pergjithshme

1. Asambleja e Pergjithshme e Shoqerise eshte organi me i larte i saj dhe ka te drejte te vendose per cdo ceshtje qe i perket Shoqerise. Vendimet e ligjshme te saj obligojne dhe aksioneret qe mungojne ose qe nuk jane dakort.

2. Asambleja e Pergjithshme perbehet nga dy dhoma:
a.dhoma e aksionereve;
b.dhoma e perfaqesuesve te personave te siguruar.
Çdo dhome zgjedh anetaret e vet ne Keshillin Mbikqyres.

3.Dhoma e aksionreve ka te drejten e vetos per çdo vendim te Asamblese se Pergjithshme.

4.Ne dhomen e perfaqesuesve te personave te siguruar, perfaqesohen punedhenesit jo aksionmbajtes te perfshire ne Institutin privat te pensioneve suplementare dhe punemarresit e tyre, punemarresit e punedhesve aksionmbajtes te Institutit privat te pensioneve suplementare, si dhe individet e perfshire individualisht ne Institutin privat te pensioneve.

5.Numri i perfaqesuesve te personave te siguruar ne dhomen e perfaqesuesve te Asamblese se Pergjithshme, nuk duhet te jete me i madh se 30 persona.

6.Zgjedhjet per dhomen e perfaqesuesve, organizohen nga :
a. punedhenesi kur ai ka me shume se 50 punemarres, per personat e siguruar te punesuar prane tij.

b.te gjithe punedhenesit se bashku kur ata kane me pak se 50 punemarres, per personat e siguruar te punesuar prej tyre.

c. te vete te interesuarit per individet e perfshire individualisht ne Institutin privat te pensioneve suplementare.

7.Rregullat e perfaqesimit te personave te siguruar ne dhomen perfaqesuesve te Asamblese se Pergjithshme jane si me poshte:

a.Personat e siguruar, te punesuar ne subjekte te cilet kane me shume se 100 punemarres, zgjedhin perfaqesuesin e tyre ne Asamblene e Pergjithshme duke patur ne konsiderate raportin 1 perfaqesues per 50 punemarres.

b.Personat e siguruar, te punesuar ne subjekte te cilet kane me pak se 100 punemarres, por me shume se 50, zgjedhin perfaqesuesin e tyre ne Asamblene e Pergjithshme duke patur ne konsiderate raportin 1 perfaqesues per 50 punemarres.

c.Personat e siguruar, te punesuar ne subjekte te cilet kane me pak se 50 punemarres, kane te drejte te perfaqesohen ne Asamblene e Pergjithshme, se bashku me punemarres te subjeketeve te tjera, qe kane me pak se 50 punemarres, perkundrejt zgjedhjes se nje perfaqesuesi per 50 punemarres (te te gjithe subjeketeve).

d.Individet, e siguruar ne Institutin privat te pensioneve suplementare kane te drejte te perfaqesohen ne Asamblene e Pergjithshme, perkundrejt zgjedhjes se nje perfaqesuesi per 50 individe.

8.Perfaqesuesit e personave te siguruar ne Dhomen e Perfaqesuesve te Asamblese se Pergjithshme zgjidhen nje here ne 4 vjet nga te siguruarit, te punesuar ne ndermarjet e punedhenesve qe zoterojne aksionet.

3. Asambleja e Pergjithshme vendos per:
   d. anetaret e Keshillit Mbikqyres te Institutit Privat te Pensioneve nepermjet procedures se zgjedhjes, dhe do te kerkoje nga Inspektoriati miratimin e tyre;
   e. miratimin e Statutit te Institutit Privat te Pensioneve dhe te ndryshimeve ne te;

f. miratimin e raporti vjetor te Institutit Privat te Pensioneve;
g. miratimin e bilancit vjetor, llogarive te Institutit Privat te Pensioneve;
h. miratimin e raportit te Keshillit Mbikqyres per veprimtarine ekonomike te Institutit Privat te Pensioneve;
i. miratimin e rregulloreve te Institutit Privat te Pensioneve dhe ndryshimeve ne to;
j. veprimtarine 2-vjeçare te Institutit Privat te Pensioneve ne raport me parashikimet afatgjata.;
k. likuidimin e Institutit Privat te Pensioneve;
l. zmadhimin ose zvogelimin e Kapitalit Aksionar sipas percaktimeve te bera ne kete statut.

**Neni 16**
**Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme**

1 Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve thirret nga Keshilli Mbikqyres dhe mblidhet rregullisht ne seline e Institutite te pakten nje here ne vit, gjithnje brenda gjashte muajve nga perfundimi i cdo periudhe financiare te Institutit. Keshilli Mbikqyres mund te therrase ne mbledhje te jashtezakonshme Asamblene e Pergjithshme, kur e gjykon te domosdoshme.
2. Asambleja e Pergjithshme, me perjashtim te mbledhjeve te perseritura dhe atyre te ngjashme me to, duhet te thirret te pakten njezet (20) dite te plota para dates se caktuar per mbledhjen e saj. Sqarohet se llogariten edhe ditet e pushimit. Dita e publikimit te thirrjes se Asamblese se Pergjithshme dhe dita e mbledhjes se saj nuk llogariten.

**Neni 17**
**Thirrja - Rendi i Dites i Asamblese se Pergjithshme**

1. Thirrja e Asamblese se Pergjithshme, e cila permban me saktesi te pakten godinen, daten dhe oren e mbledhjes, si edhe ceshtjet e rendit te dites, afishohet ne nje vend te dukshem te nderteses te Shoqerise.
2.Çdo aksioner mund te perfaqesohet vetem nga nje aksioner tjeter ose nga bashkeshorti/bashkeshortja. Aksioneret qe duan te marrin pjese ne Asamblene e Pergjithshme duhet te dorezojne fillimisht ne banke aksionet e tyre ose çertifikatat e depozitimit te aksioneve nga nje banke tjeter.
3. Ne rast se nje aksion i takon me shume se nje personi, per çdo shkak dhe arsye ata jane te detyruar te percaktojne perfaesuesin e tyre te perbashket i cili do te ushtroje te drejtat e tyre aksionere ne pergjithesi.
4.Bordi Drejtues eshte i detyruar te vere ne dispozicion te aksionereve te pakten 15 dite para mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme dokumentacionin qe percaktohet nga neni 136 i Ligjit 7638/92, sipas procedures qe pershkruhet ne kete nen, si dhe kopje te listes se aksionereve dhe te anetareve te Keshillit Mbikqyres te Institutit.
5. Çdo anetar i Asamblese se Pergjithshme, duke filluar qe nga momenti i lajmerimit te mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme te zakonshme, ka te drejte qe ne seline e Institutit te informohet per te gjitha çeshtjet e parashikuara ne nenin 143 te Ligjit 7638/92 dhe sidomos per keto:
a.rregjistrimin, bilancin vjetor, listen e anetareve te Bordit Drejtues dhe te Keshillit Mbikqyres;

b.raportet e Bordit Drejtues, Keshillit Mbikqyres dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
c.shumen e sakte te shperblimit qe marrin personat e mesiperm.
6.Anetaret e Keshillit Mbikqyres, anetaret e Bordit Drejtues dhe ekspertet kontabel te autorizuar, mund te marrin pjese ne te gjitha mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme me vota consultative. Ata kane vote vendimore kur kane cilesine e aksionerit.
7. Inspektoriati i eve Private te Pensioneve Suplementare ftohet te marre pjese ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme. Inspektoreve ju vihen ne dispozicion dokumentet qe do te diskutohen ne Asamblene e Pergjithshme, me qellim qe te mundesohet studimi i tyre e te merrren te gjitha masat e nevojshme, kur ato jane ne kundershtim me ligjin nr.7943, date 1.06.1995 (i ndryshuar).

## Neni 18
## Pjesemarrja e thjeshte dhe shumica e Asamblese Pergjithshme

1. Asambleja e Pergjithshme ploteson pjesemarrjen dhe zhvillon seance te rregullt per temat e rendit te dites kur ne te perfaqesohet te pakten pesedhjete per qind (50%) e Kapitalit Aksionar te derdhur, per seancen e pare.
2. Ne qofte se nuk plotesohet kjo pjesemarrje ne seancen e pare, thirret mbledhje perseritese brenda njezet (20) diteve nga data e seances se shtyre, me thirrjen e Keshillit Mbikqyres te pakten para (10) ditesh. Mbledhja perseritese ne fjale ploteson pjesemarrjen dhe zhvillon seance te rregullt per ceshtjet e rendit fillestar te dites, kur ne te jane present personalisht ose perfaqesuesit e aksionereve qe perfaqesojne njezete e pese per qind (25%) e Kapitalit Aksionar te derdhur.
3. Vendimet e Asamblese se Pergjithshme merren me shumice absolute te votave qe perfaqesohen ne kete mbledhje. Dhoma e aksionereve ka te drejten e vetos ne çdo vendim te Asamblese se Pergjithshme.

## Neni 19
## Pjesemarrja e jashtezakonshme dhe shumica e Asamblese se Pergjithshme

1. Ne rast te jashtezakonshem, Asambleja e Pergjithshme ploteson pjesemarrjen dhe zhvillon seance te rregullt per ceshtjet e rendit te dites kur perfaqesohen ne te pakten shtatedhjete e pese per qind (75%) e Kapitalit Aksionar te derdhur, kur eshte fjala per vendime qe kane te bejne me :

a. Zgjatjen e afatit, shkrirjen ose shperndarjen e Shoqerise.

b. Shtimin ose pakesimin e Kapitalit Aksionar, me perjashtim te çeshtjeve te percaktuara ne kete Statuti.

c. Nryshimin e menyres se administrimit te fitimeve.

d. Rritjen e detyrimeve te aksionereve dhe,

e. Ne cdo rast tjeter kur ligji percakton se per marrjen e nje vendimi te caktuar nga Asambleja e Pergjithshme kerkohet pjesemarrja sipas ketij paragrafi.

2. Ne qofte se nuk plotesohet pjesemarrja sipas paragrafeve te mesiperm ne seancen e pare, atehere brenda njezet (20) ditesh nga kjo seance dhe me thirrjen e Keshillit Mbikqyres te pakten dhjete (10) dite te plota me pare, mblidhet ne seance te pare te perseritur, e cila ploteson pjesemarrjen dhe zhvillon rregullisht seancen per ceshtjet e rendit fillestar te dites, kur ne te perfaqesohet te pakten pesedhjete per qind (50%) e Kapitalit Aksionar te derdhur.

3. Ne qofte se nuk plotesohet as kjo pjesemarrje, atehere mblidhet perseri brenda njezet (20) ditesh ne nje seance e dyte e perseritur, me thirrje nga ana e Keshillit Mbikqyres te pakten dhjete (10) dite te plota me pare, e cila ploteson pjesemarrjen dhe zhvilllon seancen rregullisht per ceshtjet e rendit fillestar te dites, kur ne te perfaqesohet te pakten tridhjete e tre per qind (33%) e Kapitalit Aksionar te derdhur.

4. Te gjitha vendimet e par. 1 te ketij neni merren me shumicen e dy te tretave (2/3) te votave qe perfaqesohen ne Asamble. Dhoma e Aksionereve ka te drejten e vetos mbi vendimet e Asamblese se Pergjithshme.

**Neni 20**
**Kryesusi i Asamblese se Pergjithshme**

1. Asamblene e Pergjithshme e kryeson Kryetari i Keshillit Mbikqyres, ose ne mungese te tij, nje nga zevendesit e tij. Detyren e sekretarit e kryen personi qe caktohet nga Kryetari.

2.Emrat e atyre qe marrin pjese ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme shenohen ne "Librin e Pjesmarrjes"

**Neni 21**
**Ceshtjet e diskutimit- Proçesverbali i Asamblese se Pergjithshme**

1. Diskutimet dhe vendimet e Asamblese se Pergjithshme kufizohen ne ceshtjet qe permban rendi i dites.
2. Per ceshtjet qe diskutohen dhe qe merren vendime ne Asamble, mbahet proçesverbali, i cili nenshruhet nga Presidenti dhe nga sekretari i saj.
3. Kopjet dhe fragmentet e proçesverbalit legalizohen nga Presidenti i Keshillit Mbikqyres ose nga zevendesi i tij.

**Neni 22**
**Perberja e Keshillit Mbikqyres**

1. Shoqeria drejtohet nga Keshilli Mbikqyres qe perbehet nga shtate (7) anetar, nga te cilet 5 anetare zgjidhen nga aksioneret dhe 2 anetare nga perfaqesuesit e personave te siguruar.
2. Anetaret e Keshillit Mbikqyres zgjidhen nga Asambleja e Pergjithshme per nje periudhe pese (5) vjecare, e cila shtyhet deri ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme qe do te miratoje rezultatet financiare, te vitit financiar qe u mbyll.
3.Perfaqesuesit aksionereve mbajtes te aksioneve, anetare te Keshillit Mbikqyres, zgjedhin Kryetarin dhe Zevendeskryetarin e pare te tij. Perfaqesuesit e personave te siguruar ne Keshillin Mbikqyres zgjedhin zevendeskryetarin e dyte te tij. Ne rast se ata

nuk bien dakort per nje gje te tille, Kryetari emeron njerin prej tyre si zvendeskryetari te dyte te Keshillit Mbikqyres.
4. Anetaret e Keshillit Mbikqyres mund te rizgjidhen lirisht.
5.Anetaret e Keshillit Mbikqyres mund te jene personat fizike mbi 18 vjeç qe:
a.kane zotesi juridike per te vepruar;
b.jane te respektueshem;
c.jane te afte profesionalisht.
6. Nuk mund te jene anetare te Keshillit Mbikqyres anetaret e organeve drejtuese te ive te fera te pensioneve, bankave, shoqerive te kambizmit, bursave e shoqerive Investuese.
7. Anetaret e Keshillit Mbikqyres hiqen kur:
a.denohen per vepra penale;
b.japin doreheqjen;
c.jane te paafte menderisht ose fizikisht;
d.zgjidhen ose emerohen ne nje funksion apo detyre qe bie ndesh me funksionin apo detyren qe kryen ai.
e.nuk gezojne besimin e aksionereve dhe te perfaqesuesve te personave te siguruar.
8. Mosmarrja pjese ne menyre te vazhdueshme e nje anetari te Keshillit Mbikqyres ne mbledhjet e tij, si pasoje e vdekjes, shkarkimit nga detyra apo mungeses se pajustifikuar e anetarit te Keshillit Mbikqyres per nje periudhe kohore me te madhe se tre muaj, konsiderohet si doreheqje e tij, qysh ne momentin qe Keshilli Mbikqyres vendos per kete gje dhe ben shenimin perkates ne proçesverbal. Keshilli Mbikqyres mund te zgjedhe edhe zevendesin e tij deri ne mbledhjen e pare te Asamblese se Pergjithshme.

**Neni 23**
**Kompetencat e Keshillit Mbikqyres**

1. Keshilli Mbikqyres ka ne kompetence te tij:
a.te zgjedhe anetaret e bordit drejtues;
b.te vendose per investimet e medha, kufiri i te cilave percaktohet nga Asambleja e Pergjithshme;
c.te kerkoje raporte te rregullta nga bordi drejtues;
d.te raportoje ne Asamblene e Pergjithshme.
2. Anetaret e Keshillit Mbikqyres nuk mbajne pergjegjesi personale kundrejt te treteve dhe kundrejt aksionereve te Institutit, por kane pergjegjesi kundrejt personit juridik te Institutit per detyrat qe u jane ngarkuar.

**Neni 24**
**Mbledhja e Keshillit Mbikqyres**

Keshilli Mbikqyres mblidhet me ftese te Kryetarit te tij prane selise se Institutit, te pakten nje here ne muaj dhe ne rast se ai nuk ka mundesi nga Zevendeskryetari i pare i tij. Kryetari i tij ka te drejte te therrase Keshillin Mbikqyres kurdoqofte, sipas gjykimit te tij, ose kur ja kerkojne dy anetare te tij.

**Neni 25**
**Perfaqesimi i anetareve-Pjesemarrja-Shumica**

1. Anetari i Keshillit Mbikqyres qe mungon, mund te perfaqesohet nga nje anetar tjeter i tij. Cdo anetar mund te perfaqesoje vetem nje anetar qe mungon.
2. Keshilli Mbikqyres ploteson pjesemarrjen dhe zhvillon seance te rregullt kur ne te asistojne ose perfaqesohen gjysma plus nje e anetareve, por asnjehere numri i keshilltareve te pranishem nuk mund te jete me i vogel se katrer. Per gjetjen e numrit te plotesimit te pjesemarrjes, nuk merret parasysh thyesa qe mund te dale.
3. Inspektoriati i eve Private te Pensioneve Suplementare, ftohet te marre pjese ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme. Inspektoreve ju vihen ne dispozicion dokumentet qe do te diskutohen ne Asamblene e Pergjithshme, me qellim qe te mundesohet studimi i tyre e te merrren te gjitha masat e nevojshme, kur ato jane ne kundershtim me ligjin nr.7943, date 1.06.1995 (i ndryshuar).
4. Vendimet e Keshillit Mbikqyres merren me shumice absolute te anetareve te pranishem dhe votave te perfaqesuara.
5. Asnje anetar nuk ka te drejte te refuzoje nenshkrimin e proçesverbalit te mbledhjeve ne te cilat mori pjese, por ka te drejte te kerkoje permendjen e mendimit te tij ne kete proçesverbal, ne qofte se nuk eshte dakord me vendimin e marre.

## Neni 26
## Proçesverbali i mbledhjes se Keshillit Mbikqyres

1. Per diskutimet qe behen dhe vendimet qe merren, mbahet proçesverabl i cili nenshkruhet nga anetaret prezente.
2. Kopjet dhe fragmentet e proçesverbalit te Keshillit Mbikqyres legalizohen nga Kryetari i tij ose nga Zevendesi i pare i tij.

## Neni 27
## Ruajtja e sekretit mbi informacionin

1. Anetaret e Keshillit Mbikqyres te Institutit, detyrohen te ruajne sekretin mbi informacionin e marre gjate kryerjes se funksionit, ose ne lidhje me kete funksion, me perjashtim te rasteve te parashikuara ne ligj. Kete detyrim ata e kane edhe pas perfundimit te marredhenieve te tyre me Institutin.

## Neni 28
## Perberja e Bordit Drejtues

1.Bordi Drejtues do te perbehet nga jo me pak se 5 anetare te afte profesionalisht, te zgjedhur nga Keshilli Mbikqyres. Nje nga keta anetare do te zgjidhet si Kryetar dhe nje tjeter si zevendeskryetar i Bordit Drejtues.
2. Anetare te Bordit Drejtues mund te jene personat fizike mbi 18 vjeç qe:
a.kane zotesi juridike per te vepruar;
b.jane te respektueshem;
c.jane te afte profesionalisht.
3. Nuk mund te jene anetare te Bordit Drejtues, anetaret e organeve drejtuese te ive te tjera te pensioneve, bankave, shoqerive te kambizmit, bursave e shoqerive investuese.
4. Anetaret e Bordit Drejtues hiqen kur:
a.denohen per vepra penale;
b.japin doreheqjen;

c.jane te paafte menderisht ose fizikisht;
d.zgjidhen ose emerohen ne nje funksion apo detyre qe bie ndesh me funksionin apo detyren qe kryen ai.
e. nuk gezojne besimin e aksionereve.

**Neni 29**
**Kompetencat e Bordit Drejtues**

1.Bordi Drejtues perfaqeson Institutin ne marredhenie me te tretet dhe eshte kompetent te vendose per çdo çeshtje qe ka te beje me drejtimin e tij, administrimin e pasurisé se tij dhe ne pergjithesi ne arritjen e qellimeve te tij, brenda objektit te Institutit, por kufizohet nga ato kompetenca qe ligji dhe statuti ua jep shprehimisht Keshillit Mbikqyres dhe Asamblese se Pergjithshme.
2. Bordi Drejtues ka ne komeptenece per aq sa i eshte njohur atij me ligj per:
a.drejtimin e Institutit te pensioneve;
b.ndermarrjen e veprimeve financiare;
c.raportimin ne Keshillin Mbikqyres,

**Neni 30**
**Mbledhjet e Bordit Drejtues**

1. Bordi Drejtues menjehere pas zgjedhjes se tij mblidhet dhe formohet si trup (organ) duke zgjedhur Kryetarin dhe Nenkryetarin e tij.
2.Kryetari i Bordit Drejtues drejton mbledhjet. Kryetarin, kur mungon ose kur pengohet, e zevendeson ne gjithe shtrirjen e kompetencave te tij zvendeskryetari dhe kete te fundit, kur nuk mund te marre pjese, me vendim te Bordit Drejtues, e zevendeson nje anetar i tij.
3. Detyren e Sekretarit te Bordit Drejtues e kryen njeri nga anetaret e tij ose cdo person tjeter i caktuar nga Bordi Drejtues.

**Neni 31**
**Zevendesimi i anetarit te Bordit Drejtues**

